

**SHPALLJE E DATËS DHE PUBLIKIMI I KRITEREVE TË VLERËSIMIT TË
DOSJEVE TË KANDIDATURAVE PËR DREJTUES TË SHËRBIMIT NË
STRUKTURAT SHËNDETËSORE UNIVERSITARE**

Ne zbatim te nenit 28, të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë”, të pikës 5 të VKM Nr. 424 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës së përzgjedhjes të emërimit të drejtuesve të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare”, i ndryshuar, Udhëzimit të Përbashkët Nr. 644, datë 11.09.2018 “Për miratimin e kriterëve të vlerësimit të kandidatëve për drejtues të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare”, Urdhërit e Përbashkët Nr. 684 datë 28.09.2018 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për përzgjedhjen e drejtuesëve të Shërbimit të Strukturave Shëndetësore Universitare”, dhe Vendimit nr. 02 dt.12.10.2018 të Komisionit të posaçëm për përzgjedhjen e drejtuesve të shërbimit të strukturave shëndetësore universitare; **shpallen kriteret e vlerësimit të dosjeve të kandidatëve për drejtues të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare, sipas Lidhjes nr. 1 “Lista e shërbimeve të Q.S.U. Nënë Tereza”, dhe Lidhja nr. 2 “Kriteret dhe dokumentat”.**

Data e aplikimit për procedurën e përzgjedhjes së kandidaturave për drejtues të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare do të jete nga data **19.10.2018 ora 09:00**, deri më **05.11.2018, ora 16:00**.

Dokumentacioni duhet të dorëzohet pranë zyrës së burimeve njerëzore të Fakultetit të Mjekësisë.

Data e zhvillimit të konkurimit do të jetë data **19.11.2018, dhe në vijim**.

Lidhja nr. 1

Lista e Shërbimeve të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza"

1. Shërbimi i Kardiologji I
2. Shërbimi i Kardiologji II
3. Shërbimi i Kardiokirurgjisë
4. Shërbimi i Kirurgjisë Vaskulare
5. Shërbimi i Gastrohepatologjisë
6. Shërbimi i Hipertonisë dhe Mjekësisë Interne
7. Shërbimi i Endokrinologjisë
8. Shërbimi i Nefrologjisë dhe Hemodializës
9. Shërbimi i Labororit të Imunologjisë
10. Shërbimi i Labororit të Gjenetikës
11. Shërbimi i Urgjencave Polivalente
12. Shërbimi i Anestezi Reanimacionit
13. Shërbimi i Kirurgjisë së Përgjithshme I
14. Shërbimi i Kirurgjisë Urologjike II
15. Shërbimi i Kirurgjisë së Përgjithshme dhe Digjестive III
16. Shërbimi i Djegie Plastike
17. Shërbimi i Labororit Klinik Biokimik
18. Shërbimi i Labororit Mikrobiologjik
19. Shërbimi i Imazherisë dhe Mjekësisë Nukleare
20. Shërbimi i Toksikologjisë Klinike
21. Shërbimi i Labororit të Anatomisë Patologjike
22. Shërbimi i Neurologjisë
23. Shërbimi i Psikiatrisë
24. Shërbimi i Neurokirurgjisë
25. Shërbimi i Neurovaskular (Stroke dhe Post Stroke)
26. Shërbimi i ORL
27. Shërbimi i Okulistikës
28. Shërbimi i Pediatriisë së Specialiteteve I

29. Shërbimi i Pediatriisë së Specialiteteve II
30. Shërbimi Onkohematologjisë
31. Shërbimi i Nefrologjisë Dhe Dializës Pediatrike
32. Shërbimi i Kirurgjisë Infantile Pediatrike
33. Shërbimi i Reanimacionit Pediatrik
34. Shërbimi i Urgjencës dhe Pediatriisë së Përgjithshme
35. Shërbimi i Pediatriisë Infektive
36. Shërbimi i Onkologjisë
37. Shërbimi i Hematologjisë
38. Shërbimi i Sëmundjeve Infektive
39. Shërbimi i Reumatologjisë
40. Shërbimi i Alergologjisë
41. Shërbimi i Dermatologjisë

Lidhja nr. 2

KRITERET DHE DOKUMENTAT PËR KANDIDIM

- 1.** Kërkesa me shkrim e shoqëruar me fotokopje e dokumentit të identifikimit.
- 2.** Curriculum vitae.
- 3.** Diplomë në “Mjekësi të Përgjithshme”.
- 4.** Diplomë e specialitetit të shërbimit.
- 5.** Diplomë e titullit “Profesor”, (nëse ka).
- 6.** Diplomë e titullit Profesor i Asociuar”, (nëse ka).
- 7.** Diplomë Doktoratë/PhD, të mbrojtur në një nga universitetet e Shqipërisë, të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Turqisë, Australisë ose Japonisë;
Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njehsuar, sipas legjislacionit në fuqi nga strukturat përkatëse.
- 8.** Kandidatët që kanë vetëm shtetësi të huaj, duhet të paraqesin çertifikatën e mbrojtjes së gjuhës shqipe, me përjashtim të rasteve kur kandidati ka kryer një cikël të plotë studimesh në gjuhën shqipe dhe paraqet diplomën e noterizuar.
- 9.** Të dorëzojë nga Urdhri I Mjekut:
 - a.** Licenca e Ushtrimit të profesionit;
 - b.** Vërtetim anëtarësimi nga Urdhëri i Mjekut;
 - c.** Vërtetim që nuk ka asnjë dënim të dhënë nga Urdhri i Mjekut
- 10.** Kontrata ose vërtetimi që është mjek pedagog me kohë të plotë jo më pak se 5 (pesë) vjet), me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar në IAL-në përkatëse dhe të ketë të njëjtin specialitet në shërbimin shëndetësor universitar, për të cilin kandidon, ose të jetë/të ketë qenë mjek pedagog me kohë të plotë i strukturave universitare homologe të Bashkimit Evropian ose vendeve anëtare të OECD. Në rastet kur asnjë nga pjesëtarët e stafit mjekësor nuk plotëson kriterin e sipërpërmendur, mund të pranohen edhe kandidatë me përvojë akademike, jo më të shkurtër se 8 (tetë) vjet, pa nderprerje si pedagog me kohë të pjesshme. Konsiderohet përvojë akademike aktiviteti didaktik i kryer në institucione publike të arsimit të lartë apo në institucione jopublike të arsimit të lartë, të akredituara dhe në programe studimi të akredituara brenda vendit, në periudhën e përvojës së kryer. I njëjti kriter vlen dhe për institucionet dhe programet e akredituara/e njohura në një nga vendet e Bashkimit Evropian ose vendet anëtare të OECD;
<http://www.oecd.org/about/membersandpartners/list-oecd-member-countries.htm> ;

(Kur dorëzohet vërtetimi, ai duhet të përmbajë, së paku, llojin e kontratës (me kohë të plotë apo të pjesshme), datën e nisjes dhe përfundimit (nëse ka) të marrëdhënies kontraktuale (kohëzgjatja e kontratës së punës), dhe departamenti dhe specialiteti mjekësor ku aplikanti është pedagog)

11. Të mos ketë qenë asnjëherë i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë, duke e vërtetuar këtë, me paraqitjen e:

a. Formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

<http://www.dap.gov.al/images/cover%20page%20dekriminalizimin.pdf>,

b. Formulari i vetëdeklarimi për gjëndjen gjyqësore ose deshmi penaliteti:

<http://www.dpbsh.gov.al/newweb/?fq=brenda&m=shfaqart&gj=gj1&aid=544>

12. Vërtetim nga institucioni shëndetësor që kandidati ka përvojë klinike/diagnostike jo më pak se 10 (dhjetë) vjet në specialitetin përkatës, ku të përcaktohet qartësisht, specialiteti ku është ushtruar aktiviteti mjekësor dhe data e nisjes dhe përfundimit (nëse ka përfunduar) të eksperiencës përkatëse.

13. Dokumentacion që provon aftësitë profesionale dhe organizative

14. Projekti 4-vjecar për zhvillimin dhe drejtimin e shërbimit. Projekti, duhet të paraqesë të dhëna dhe produkte konkrete të matshme të cilat do të shërbejnë më pas si bazë për vlerësimin e punës së drejtuesit të ardhshëm të shërbimit që i ka paraqitur ato.

Kërkesa dorëzohet pranë zyrës së burimeve njerëzore të fakultetit, pjesë e të cilit është shërbimi ku do të konkurrojnë.

Për çdo sqarim mund të kontaktoni në adresën e email: info@umed.edu.al

Kujdes!

Dokumentacioni i dorëzuar duhet të jetë në origjinal ose kopje e noterizuar dhe në gjuhë shqipe. Në rast paraqitje dokumentacioni në gjuhë të huaj, ky i fundit duhet të dorëzohet i përkthyer dhe noterizuar.

